KËRKESË
Nr. 836/5, datë 2.10.2025

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën, "Për një ndryshim në VKM-në nr. 61, datë 29.1.2025, 'Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Ndërtimi i fiderave me kabllo 20 kV, V4, V5 dhe kabinave të reja nga nënstacioni i ri Valias", i ndryshuar" me vlerë totale paraprake 17 208 (shtatëmbëdhjetë mijë e dyqind e tetë) lekë.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur.

a) Vlerësimi i pasurisë së llojit "arë" është llogaritur bazuar në pikën 4, të nenit 17, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", i ndryshuar, në marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligjin nr. 41/2019 "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a dhe KfW-së, Frankfurt *AM Main*, për programin e Investimeve për Shpërndarjen e Energjisë Elektrike I", për financimin e projektit "Ndërtimi i fiderave me kabëll 20 kV, V4, V5 dhe kabinave të reja nga nënstacioni i ri Valias". Raporti i vlerësimit nga ekspertët e kontraktuar nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a. dhe miratuar nga Banka KfW-së, si më poshtë vijon.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar, dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, tek Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a., si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit 17 208 (shtatëmbëdhjetë mijë e dyqind e tetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena

LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "PËR NJË NDRYSHIM NË VKM-në NR. 61, DATË 29.1.2025, 'PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT 'NDËRTIMI I FIDERAVE ME KABLLO 20 kV, V4, V5 DHE KABINAVE TË REJA NGA NËNSTACIONI I RI VALIAS", I NDRYSHUAR"

Nr.	Nr. i shtyllës	Pronari			Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)							Vlerësimet për shpronësim					Shënime *(kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë, etj.)*
												"Arë"/ truall					
		Emër	Atesia	Mbiemër	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Vlera e drutorëve (lekë)	Vlera totale (lekë)	
8	K15/V4	Armand Denisa	Hamdi Ramazan	Çela Çela	Valias	1514	380/91	Are	2761	9	110	24	717	17208		17208	
Vlera totale																17208	

Shënim. Efekti financiar shtesë, për pasuritë të cilat kërkohet të ndryshohen të dhënat e pronësisë, është me efekt 0, pasi vlera e tyre është pasqyruar në VKM-në bazë nr. 61, datë 29.1.2025, konkretisht në numrin rendor 8.